



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.913/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Milena Đerić kryesuese, Rustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtare në Kuvend Komunal në Prishtinë nga Subjekti Politik Aleanca Kosova e Re, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvend Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 06.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet si i bazuar apeli Anr.913/2021 i datës 04.11.2021 paraqitur nga kandidati Adem Haxholli për anëtar në Kuvend Komunal në Prishtinë nga Subjekti Politik Aleanca Kosova e Re, me seli në Prishtinë.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj fletëvotimet vetëm për Kandidaten në Kuvend Komunal në Prishtinë nga Subjekti Politik Aleanca Kosova e Re, me seli në Prishtinë, në Qendrat e Votimit 1921X/01R, 1931E/02R, 1957E/01D.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutitë e Vendvotimit si në pikën - II- të këtij dispozitivi, të përfshihet në rezultatin përfundimtar.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021 të kandidatit për anëtar në Kuvend Komunal në Prishtinë nga Subjekti Politik Aleanca Kosova e Re, me seli në Prishtinë, në të cilën pretendon se ka fakte të se votat e ti janë keqpërdorur dhe nuk figurojnë në emrat ku i kane dhënë votuesit. Duke qenë i bindur në parregullsi në procesin e votimit ka kërkuar nga PZAP që në vendvotimet 1921X/01R, 1931E/02R, 1957E/01D të dërgohen në rinumërim për shkak se votat e familjarëve të ti në këto qendra nuk figurojnë dhe si rezultat i tyre është dëmtuar. Si dëshmi apelit i ka bashkangjitur deklaratat e personave që e kanë votuar ndërsa në këto vendvotime i figurojnë 3 vota, ndërsa në baze të deklaratave duhet të kishte se paku 6 vota.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, vlerësimit të provave të bashkangjitura dhe sipas hetimit të kryer nga vet PZAP, në ankesë në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i bazuar

Nga shkresat e lëndës, kandidati për anëtare në Kuvend Komunal në Prishtinë nga Subjekti Politik Aleanca Kosova e Re, me seli në Prishtinë, brenda afatit ligjor, ka parashtruar apel ku

ka kërkuar nga PZAP-i, që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve vetëm për kandidatin për asamble në vendvotimet 1921X/01R, 1931E/02R, 1957E/01D.

Paneli vlerëson se apeli është i bazuar sa i përket vendvotimeve si në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi, pasi që mbështetet edhe në prova të dorëzuara nga kandidati, ku shihet se nga deklaratat gjithsejtë 6 votuesve të bashkangjitura në shkresat e lëndës me deklarinimin se në vendvotimet 1921X/01R, 1931E/02R, 1957E/01D e kanë votuar kandidatin kandidatit për anëtare në Kuvend Komunal Adem Haxholli ndërsa në këto qendra pas kërtimeve i figurojnë vetëm 3 vota.

Paneli, vlerëson se ky rinumërim e bënë procesin e numërimit të fletëvotimeve dhe shpalljen e rezultateve të saktë në kuptim të nenit 101 paragrafi 1 i LZP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Procedura e numërimit të fletëvotimeve qeverisen nga objektivat e mëposhtme: saktësia, transparenca, efikasiteti, mundësia për rinumërim dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës”*. Nga kjo rezulton se mos procedimi i fletëvotimeve sipas dispozitës së lartë cituar, përveç cenimit të saktësisë, transparencës dhe kredibilitetit, po ashtu cenon integritetin e procesit zgjedhor dhe se pa evitim e kësaj parregullsie, përmes rinumërimit, ky integritet dhe kredibilitet do të vihet në pikëpyetje. Për çka mbi bazën e të lartë cekurave Paneli, ka vendosur si në pikën -I- dhe -II- të dispozitivit të këtij vendimi.

Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimet e lartcekura. Si në pikën II të dispozitivit.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 dhe 120 par. Pika d) të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.913/2021 më datën 06.11. 2021

Kryesuese e Panelit
Milena Đerić



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.